

MIGRIMI DHE TË RINJTË



Titulli - MIGRIMI DHE TË RINJTË

Autore - Drita Memeti, Merita Zulfiu Alili, Elisabeta Ologu

Botues - Rrjeti i Grave në Shkencë

Shtypi - Shtëpia Botuese SYTH

Vendi- Republika e Maqedonisë së Veriut, Shkup

Viti - 2024

Publikimi “Migrimi dhe të rinjtë” është përgatitur nga Rrjeti i Grave në Shkencë në kuadër të Platformës për Investim në Komunitet / Community Investment Platform - CIP , i financuar nga Bashkimi Evropian dhe mbështetur nga Fondacioni Albiz.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA.....	3
HYRJA.....	4
SHKAQET DHE PASOJAT E MIGRIMIT NË RMV.....	5
STRATEGJITË E PARANDALIMIT TË MIGRIMIT.....	13
TË DHËNAT STATISTIKORE.....	14
REKOMANDIMET.....	25
LITERATURA.....	27
SHTOJCA.....	28

HYRJE

Në suaza të projektit me titull “TË RINJËTË DHE MIGRIMI”, Rrjeti i Grave në Shkencë si pjesë e “Platformës për investime në komunitet” (CIP) e cila është financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Fondacioni Albiz nga Shkupi, në partneritet me Shoqatën Multikultura nga Tetova, Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit nga Dibra dhe Qendrën për hulumtime dhe analiza NOVUS nga Strumica, do të realizojnë hulumtim shkencorë të ndarë në dy faza kryesore, teorike dhe praktike. Ky hulumtim realizohet me qëllim që të trajtohet në formë të detajuar migrimi i të rinjve si dukuri në rritje.

Migrimi është një proces i vazhdueshëm i cili e ka përcjell shoqërinë tonë që nga e kaluara e deri më sot. Me ulje ngritjet e tij si fenomen në vete ka prekur të gjitha shtete e botës por me theks të veçantë vendet më të varfëra të cilat migrimin e shohin si opsion të vetëm për të ndërtuar të ardhmen e tyre. Sipas të dhënave statistikore nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) bazuar në të dhënat e Bankës Botërore të botuara në botimin me titull “Migrimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Profili i shtetit 2021” në një analizë krahasuese prej vitit 2005 në vitin 2020 numri i personave që kanë migruar jashtë vendit është në rritje edhe atë prej 459 000 në vitin 2005 në 693 900 në vitin 2020.¹

Në fokus të këtij hulumtimi do të jenë të rinjtë të cilët kanë migruar jashtë vendit, faktorët dhe shkaqet që kanë çuar drejtë migrimit për të arritur kështu deri te pasojat të cilat i shkakton migrimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe mënyra se si mund të parandalohet fenomeni i migrimit.

Qëllimet kryesore të këtij studimi janë

- krijimi i lidhshmërisë logjike midis relacionit shkak-pasojë në raport me migrimin
- evidentimi i dukurive të cilat ndikuan në rritjen e migrimit
- monitorimi i rrjedhës së migrimit gjatë vitit 2023
- konkretizimi i pasojave negative që shkakton migrimi i të rinjve
- hartimi i një kornize elaboruese mbështetur në strategjitë e migrimit.

¹ Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Migrimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Profili i shtetit 2021, <https://north-macedonia.iom.int>

SHKAQET DHE PASOJAT MIGRIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Republika e Maqedonisë së Veriut e cila sipas regjistrimit të vitit 2021 arrin në 1,836,713 banorë (50.4% janë femra dhe 49.6% meshkuj), bën pjesë në Ballkanin Perëndimor që për ndryshe njihet si një ndër zonat më të prekura nga migrimi që për pasoj ka edhe humbje të madhe në të gjitha resurset vendore.

Sipas një studimi të bërë nga Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) dhe Institutit për Zhvillim dhe Inovacion (IDI) konstatohet se humbja në fushën e arsimit për shkak të largimit të rinjve është nga 840 milionë në 2.46 miliardë euro në vit. Kurse sa i përket Maqedonisë së Veriut për shkak të paaftësisë së saj për të parandaluar nivelet e larta të emigrimit vjetor, Maqedonia e Veriut humbet rreth 333 milionë euro, që është rreth 3.1 për qind e PBB (Prodhimi i brendshëm bruto) së saj gjatë vitit 2018. E thënë thjesht, çdo person i aftë për të punuar që largohet nga Maqedonia e Veriut merr me vete afërsisht 15,850 euro të PBB potenciale.²

Ajo që e bën më domethënëse, të rëndësishëm dhe shqetësues procesin e migrimit është fakti se pjesa më e madhe e personave që zgjedhin të braktisin vendin e tyre janë të rinjtë dhe për pasojë vendi shkon drejtë **plakjes së popullsisë, rënien e natalitetit si dhe ikjen e trurit.**

Të dhënat e migrimit sipas moshës

Përkatësisht, në vitin 2015 dhe 2020 numri i fëmijëve (0-14 vjeç) është rritur nga 54682 në 55,093 persona, dhe pjesëmarrja e tyre në numrin e përgjithshëm të migrantëve u ul nga 20.0% në 18.4%. Në të njëjtën kohë, numri i njerëzve në moshë pune (15-64 vjeç), që është 200158 persona (2015) dhe 219438 persona (2020). Në vitin 2020 nga një e treta e tyre (31.9%) janë të rinj deri në 29 vjeç, më shumë se një e katërta (27.1%) më të rinj popullsia e moshës së mesme (30-39), dhe më shumë se një e pesta (22.3%) popullsia e moshës mesatare (40-49 vjeç).

Rreth 41000 ose 18.7% e personave të aftë për punë jashtë vendit janë të moshuar prej 50 vitesh, që do të thotë se në dekadën e ardhshme mund të pritet një numër në rritje të shtetasve të Maqedonisë së Veriut jashtë vendit të cilët do të fitojnë të drejtën e pensionit. Duke marrë

² WFD, "Cost of Youth Emigration", https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-05/efd-web-brochure-nm_final.pdf, 2018

parasysh kohëzgjatja e emigrimit jashtë vendit, numri i njerëzve është në rritje të vazhdueshme më i vjetër se 65 vjet nga 12059 (2015) në 17784 persona (2020). Në këtë periudhë u dyfishua gjithashtu kontingjenti i të moshuarve (85+), nga 245 në 484 persona.³

Nga të dhënat e fundit shihet qartë se numri i të rinjve që largohen nga vendi (të cilët llogariten edhe si moshë punuese) gjithnjë e më shumë shkon në rritje gjë që e bën vendin tonë të shkoj edhe drejtë mungesës së krahut punues si dhe drejtë plakjes së popullsisë.

Plakja e popullsisë

Bazuar në të dhënat e Eurostat, në vitin 2021, mosha mesatare e BE-së ishte 44.1 vjeç, nga 43.9 në 2020.⁴

Sipas regjistrimit më të fundit të popullsisë në shtator të vitit 2021, Maqedonia e Veriut numëron 1.836.713 banorë, që do të thotë 223.081 njerëz ose 10 për qind më pak se popullsia e vlerësuar në vitin 2016 dhe 236.989 persona ose 11.4 për qind më pak krahasuar me vitin 2011. Sipas strukturës moshore Maqedonia e Veriut me migrimin e të rinjve çdo ditë e më shumë shkon drejtë plakjes së popullsisë, gjë që vërtetohet edhe sipas regjistrimit të fundit ku përqindja më e madhe e popullsisë, 7%, është në grup moshën 40-44 vjeç.⁵

Në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2021, numri i lindjeve është ulur për 4.122, dhe lindshmëria është ulur nga 11.2 ‰ në 10.2 ‰ (lindje për 1,000 banorë). Ndryshimet në strukturën moshore të popullsisë kanë reflektimin e tyre në numrin e vdekjeve në vend. Numri i personave që vdiqën kontribuoi në rritjen e shkallës së vdekshmërisë, e cila në vitin 2021 ishte 15,5 ‰, në ndryshim nga viti 2011 kur ishte 9.5 ‰ (vdekje për 1000 banorë).

Kjo erdhi si pasojë e përhapjes së pandemisë të shkaktuar COVID-19 e cila e goditi rëndë vendin tonë dhe shkaktoj pasojë të mëdha në ndryshimin e skicës moshore të popullsisë të cilët jetojnë në Maqedoninë e Veriut.

³ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rezoluta e Politikës së Migracionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2025, Shkup, dhjetor 2021, <https://northmacedonia.iom.int/sites/g/files/tmzbdl2301/files/documents/Resolution%20on%20Migration%20Policy%20of%20The%20Republic%20of%20North%20Macedonia.pdf>

⁴ Eurostat, General and regional statistics, (2021), <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database>

⁵ Enti shtetëror për statistika, Regjistrimi i popullsisë, (2022), <https://popis2021.stat.gov.mk/Активности/Вкупното-резидентно-население-на-Република-Северна-Македонија-изнесува-1-836-713-жители/>

Në periudhën nga 2010 deri në 2020, pjesëmarrja e popullsisë së re (0-14 vjeç) në total u zvogëluar nga 17.4 për qind në 16.1 për qind dhe pjesa e popullsisë së moshuar (mbi 65 vjeç) u rrit nga 11.7 për qind në 14.8 për qind.

Sa i takon rajoneve, popullsia më e re në Maqedoninë e Veriut është kryesisht në vendbanimet shqiptare, si Pollogu që është renditur si rajoni i parë, sa i takon moshës mesatare më të re të popullsisë (37 vjeç), kufi ky që po rritet.⁶

Bazuar në të dhënat e lartshënuara shihet qartë se largimi i të rinjve nga vendi e ka çuar Maqedoninë e Veriut drejtë plakjes së popullsisë dhe kjo vjen si pasojë e migrimit ku të rinjtë largohen nga vendi i lindjes gjë që me automatizëm shënohet rënia e numrit të personave të ri në listën e qytetarëve aktiv për punë si dhe zvogëlimin e numrit të lindjeve të reja të cilat si pasojë e migrimit tani do të vijojnë të realizohen në vendet në të cilat të rinjtë kanë zgjedhur të migrojnë.

Pra, në këtë rast vjen në shprehje situata shkak-pasojë ku nga dyndjet e të rinjve nga vendi vjen si pasojë rënia e natalitetit gjë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në plakjen e popullsisë në vendin tonë dhe shtimin e numrit të foshnjave të reja që lindin në shtete tjera nga qytetarë të RMV.

Faktori Ekonomik

Shkalla e lartë alarmante e papunësisë në mesin e pjesës më të lëvizshme të popullatës – rinisë – në Maqedoninë e Veriut krijon një problem kyç për të rinjtë kur ata përfundojnë arsimin e tyre: është e vështirë të gjejnë një punë në profesionin e tyre të zgjedhur dhe detyrohen që të punësohen në punë dytësore edhe pse janë të diplomuar në drejtime përkatëse ata zgjedhin të punojnë si shitës, kamerier, kuzhinier, etj.

Paga minimale është më e ulët se shporta minimale e konsumatorit dhe fitimet mesatare janë më të ulëta se shporta mesatare e konsumatorit.

Edhe ata që e gjejnë një punë kanë vështirësi për të përballuar jetesën dhe kjo si pasojë e rritjes së vazhdueshme të çmimeve në produktet bazë të cilat u nevojiten qytetarëve për të mbijetuar, duke

⁶ <https://alsat.mk/plakja-e-popullsisë-ja-ku-renditet-maqedonia/>

mos përfshi edhe nevojat sekondare të cilat shpesh herë për një pjesë të mirë të qytetarëve të RMV nuk vinë në shprehje për tu plotësuar.

Sipas vlerësimeve të OECD-së (The Organisation for Economic Co-operation and Development), mesatarisht 23,000 njerëz në vit emigruan nga Maqedonia e Veriut në vendet anëtare të OECD në 2012-2016.⁷

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave nga Anketa e fuqisë punëtore (të dhënat e anketës) të vitit 2022, popullsia aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut është 808078 persona, nga të cilët 692034 persona janë të punësuar dhe 116045 persona janë të papunë.

- Shkalla e aktivitetit është 55,2
- Shkalla e punësimit është 47,3
- Shkalla e papunësisë është 14,4

Të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave tregojnë se në vitin 2022 shkalla e papunësisë është 14,4 dhe krahasuar me vitin 2021 shënon rënie prej 1,0 pikë përqindjeje.⁸

Në bazë të të dhënave të Agjencisë për Punësim, numri më i madh i atyre që kërkojnë punë janë të rinj. Deri më 31 mars të këtij viti 10 mijë e 115 të rinj nga mosha 20 deri 24-vjeçare janë regjistruar si të papunë. Përderisa 12 mijë të tjerë i takojnë grup-moshës nga 25 deri 29-vjeçare

⁷ Organisation for Economic Co-operation and Development, Multi-dimensional Review of the Western Balkans, 2022, <https://www.oecd.org/countries/republicofnorthmacedonia/>.

⁸ Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, raporti vjetor për vitin 2022, Shkup, 2023, <https://av.gov.mk/regjistrimi-ne-evidence.nspix>

Normat e aktivitetit të popullsisë sipas grup moshave

	Shkalla e aktivitetit		Shkalla e punësimit ¹⁾		Shkalla e pa punësimit	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	55.8	55.2	47.2	47.3	15.4	14.4
15-24	29.4	28.4	18.8	19.2	36.1	32.5
25-49	82.0	82.0	70.2	70.4	14.4	14.2
50-64	62.6	61.8	54.6	55.2	12.8	10.7
65 +	4.5	3.9	4.4	3.9	:	:
15-29	46.8	46.1	33.9	34.4	27.5	25.2
15-64	66.8	66.4	56.4	56.7	15.6	14.5
20-64	72.3	72.1	61.2	61.8	15.3	14.3

Tab.1. Shkalla e punësimit - pjesëmarrja e numrit të të punësuarve në popullsinë në moshë pune, 15 vjeç e lart (sipas rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës - ILO)⁹

Të dhënat flasin qartë se në vendin tonë edhe për skaj migrimit ekziston një numër i konsiderueshëm i të rinjve të cilët janë punëkërkuese, në këtë rast nëse shteti jonë nuk arrin që të siguroj vende punë të përshtatshme sipas kërkesës dhe përgatitjes profesionale të këtyre të rinjve atëherë mund të ndodh që të rinjtë të kërkojnë perspektivën jashtë vendit për të siguruar një vend pune për një të ardhme më të mirë.

Faktori Politik

Papunësia, e kombinuar me gjendjen e shtetit ligjor, respektimin e ulët të ligjeve, perceptimet e korrupsionit, shkalla e diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe të tjera, kufizimet e lirisë së fjalës dhe perceptimet e perspektivës së këtij rajoni krijojnë një gamë të gjerë faktorësh

⁹ Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, raporti vjetor për vitin 2022, Shkup, 2023, <https://av.gov.mk/regjistrimi-ne-evidence.nspix>

shtytës. Të gjitha këto faktorë janë pasoj e politik bërjes në Maqedoninë e Veriut e cila edhe për skaj të raporteve korigjuese nga Komisionit Evropian nuk arrin ende të konsolidoj qeverisjen e saj me nevojën reale të qytetareve gjë që ndikon edhe në shtyrjen e procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.

Si pasoj e kësaj në raportin vjetor të Bashkimit Evropian për republikën e Maqedonisë së Veriut konstatohet se : “Nuk ka pasur progres të dukshëm në zbatimin e zotimeve të marra gjatë të tretës raundi i "Dialogut Jean Monnet" në fillim të vitit 2020. Këto përfshijnë ndryshimin e rregullave të procedurat, duke përfshirë edhe seancën konstituive, mbikëqyrje më të madhe qeveritare, publike seancat dëgjimore, kalendarin parlamentar dhe procedurat për ligjet me flamurin e BE-së.

Gjatë punës grupi për "Dialogun Jean Monnet" u takua dy herë në 2021 dhe një herë më shumë në 2022 për të diskutuar zbatimin e angazhimeve të marra, është bërë progres i kufizuar dhe Rregullat të procedurës mbeten të pandryshuara. Procesi duhet të përfundojë pa vonesa të mëtejshme të sigurojë një funksionim më të mirë të Parlamentit”.¹⁰

Në hulumtimin me titull “Nepotizmi: Autoritetet ndërrohen, "familjarët" mbeten”, të realizuar nga Instituti për të drejtat e njeriut, i mbështetur nga Bashkimi Evropian me autore Ruzhica Fotinovska është konstatuar se ende vazhdon të ekzistoj nepotizmi në Maqedoninë e Veriut edhe atë me theks të veçantë në radhët e administratës publike.

Përbërja e re e Komisionit Kundër Korrupsionit, që nga fillimi deri më tani ka hapur 66 raste, 26 prej të cilave janë akoma të hapura. Të tjerat janë mbyllur për shkak të vjetërsimit, elementëve të pamjaftueshëm si dhe dorëheqjeve të dhëna.

Drejtorët në institucionet publike jo rrallë e (keq) përdorin nenin 21 të Ligjit për marrëdhëniet e punës, i cili lejon manovrim për të vendosur për vendet e punës, kanë konstatuar zyrtarët antikorrupsion.¹¹

¹⁰ European Commission, North Macedonia 2022 Report, Brussels, 12.10.2022, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>, fq. 10

¹¹ Instituti për të drejtat e njeriut, “Nepotizmi: Autoritetet ndërrohen, "familjarët" mbeten, Ruzhica Fotinovska, <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/nepotizmi-autoritetet-nderrohenfamiljaret-mbeten.pdf>

Hulumtimi më i ri që është pjesë e projektit "Vlerësimi i vulnerabilitetit nga korrupsionit në politikat dhe procedurat për punësim, me fokus të veçantë në nepotizmin, kronizmin dhe klientelizmin" ka identifikuar 46 pika të ndjeshme në të cilat duhet të ndërhyhet për të parandaluar punësimin farefisnor. Përndryshe, hulumtimi skanoj shumë institucione shtetërore, ndër të cilat edhe EEM-ja dhe MEPSO-ja. Projektin punon KSHPK-ja dhe Transparency International. Me qëllim të zgjerimit dhe rritjes së ingerencave, përbërja aktuale e KSHPK-së ka përpiluar një listë me 350 vërejtje mbi ligjin sipas të cilit punojnë, në mënyrë që të bëhen më efikas. Por ndryshimet ligjore ende nuk kanë hyrë në procedurë. Rregullativa ligjore, veçanërisht filtri kryesor për korrupsionin dhe nepotizmin - KSHPK, ishin rregullisht pjesë e raportit të BE-së për përparimin e vendit në rrugën drejt Bashkimit, me theks se është i nevojshëm jo vetëm sjellja, por edhe zbatimi i ligjeve nëse duam të ndërtojmë një shoqëri qytetarë të barabartë.¹²

Mbështetur në këto të dhëna Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit – KSHPK, në raportin final të këtij projekti, konstaton se punësimet bazuar në nepotizëm, miqësi dhe klientelizëm kanë ndikuar që qytetarët punë kërkuar të humbin besimin në institucionet shtetërore.¹³

Faktori kulturor

Edhe për skaj të iniciativave të vazhdueshme të ndërmarra nga Bashkimi Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut vazhdon të vërehet diskriminimi në instance të ndryshme, ku gjatë vitit 2021 Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje kundër Diskriminimi sipas Raporti Evropian ka pranuar 167 ankesat ku nga të cilat u konfirmuan 60% të rasteve të diskriminimit në sektorin publik.¹⁴

Bazuar në të dhënat e Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje kundër Diskriminimit vërehet qarte se ekziston diskriminimi i vazhdueshëm në RMV i cili manifestohet në forma të ndryshme si në aspektin e punësimit, avancimi në vendin e punës, shpërndarjen e pozitave, shpërndarjen e buxhetit shtetëror edhe shumë situata të tjera të cilat çdo ditë e më shumë paraqesin zhgënjim te

¹² Instituti për të drejtat e njeriut, "Nepotizmi: Autoritetet ndërrohen, "familjarët" mbeten, Ruzhica Fotinovska, <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/nepotizmi-autoritete-nderrohenfamiljaret-mbeten.pdf>

¹³ Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit – KSHPK, "Vlerësimi i cënueshmërisë së korrupsionit në politikat dhe procedurat e punësimit, me fokus të veçantë në nepotizmin, miqësinë dhe klientelizmin", (2020), fq.54, <https://dksk.mk/wp-content/uploads.pdf>

¹⁴ European Commission, North Macedonia 2022 Report, Brussels, 12.10.2022, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>, fq. 31

qytetarët sidomos të rinjtë të cilët janë punë-kërkues dhe pikërisht kjo paraqitet edhe si një ndër arsytet tjera që i çojnë të rinjtë drejtë migrimit.

Përveç diskriminimit të vazhdueshëm, pabarazisë dhe pengesave të tjera për avancim në vendin tonë dekadën e fundit me të madhe zhvillohet edhe migrim si pasojë e bashkimit familjar i me çka kryefamiljarët të cilët kanë migruar tërheqin edhe pjesën tjetër të familjes në vendin ku ato kanë migruar.

Historikisht, bashkimi familjar ka qenë një nga arsytet kryesore të imigrimit në BE. Është një kanal hyrjeje që u mundëson atyre që tashmë banojnë ligjërisht në një Shtet Anëtar, t'u bashkohen atyre pjesëtarët e familjes. Për më tepër, ai ndihmon në krijimin e stabilitetit kulturor, duke lehtësuar integrimin e shtetasve të vendeve të treta që banojnë në Shtetet Anëtare të BE-së dhe, eventualisht duke promovuar ekonomik dhe kohezionin social.¹⁵

Realisht edhe ky lloj migrimi i bart në vete pasojat pozitive edhe negative. Aspekti pozitiv vërehet në segmentin e integritetit dhe ruajtjen e bërthamës familjare, por ky bashkim familjar në ndërkohë jep efektet e veta negative nga vendi edhe ku largohen qytetarët (në këtë rast RMV) me çka sjell deri në uljen e numrit të popullsisë, rënien e natalitetit si dhe plakjen e popullsisë.

Një trend tjetër i ri i migrimit është edhe migrimi në kërkim të perspektivës më të mirë gjegjësisht studimeve jashtë vendit. Dekadën e fundit një numër i madh i të rinjve migrojnë jashtë vendit me qëllim të ngritjes akademike.

Në një nivel të përgjithshëm, migrimi i të rinjve dhe të arsimuarve mund të ketë një ndikim të dëmshëm në rritjen ekonomike të një vendi. Ikja e trurit në Maqedoninë e Veriut, si në Shqipëri dhe në pjesën tjetër të Ballkanit Perëndimor, paraqet një rënie të kapitalit njerëzor dhe gjithashtu një rënie të fuqisë punëtore në sektorë prioritete si mjekësia dhe IT.¹⁶

Si të frenohet kjo humbje e studentëve të talentuar dhe të sapo diplomuar?! Kjo mbetet një sfidë e madhe, veçanërisht për një vend që është demografikisht i vogël dhe ekonomikisht dhe gjeografikisht periferik brenda Evropës siç është Maqedonia e Veriut.

¹⁵ EPRS | European Parliamentary Research Service, Legal migration to the EU, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635559/EPRS_BRI\(2019\)635559_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635559/EPRS_BRI(2019)635559_EN.pdf), fq.6)

¹⁶ Merita Zulfiu Alili, Russell King, Ilir Gëdeshi, Potential Migration of Educated Youth from North Macedonia: Can Brain Drain be Averted?; Migration Letters, 2022, fq. 80, <https://migrationletters.com/index.php/ml/article/view/2093>

Disa ndër masat më të dukshme që në vazhdimësi ju sugjerohen edhe politikëbërësve është hapja e më shumë vendeve të punës, pagat më të larta, punë më e mirë, kushtet më të mira dhe programet e duhura të trajnimit për t'iu përshtatur hyrjeve të reja në tregun e punës në ata sektorë ku ka kërkesë dhe potencial për zgjerim. Të njëjtat kushte do të ishin efektiv, në parim edhe në kthimin e studentëve të diplomuar jashtë vendit në Maqedoninë e Veriut.

STRATEGJITË E PARANDALIMIT TË MIGRIMIT

Në hartimin e Strategjisë Nacionale janë përfshirë shumë institucione shtetërore, njësi të vetëqeverisjes lokale, organizata joqeveritare dhe faktorët e tjerë relevantë që kanë të bëjnë me politikat rinore. Strategjia për migrim u hartua në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara, Programi për Zhvillim (UNDP) dhe Misionin e OSBE-së në Shkup.

Hartimi i strategjisë së re vjen si nevojë pas dështimit të strategjisë së vitit 2016, pasi ajo nuk përputhej me nevojat reale që kanë të rinjtë në Maqedoninë e Veriut.

Për sa i përket lëvizjeve të emigracionit, është domethënëse të theksohet se edhe në pesë vitet e fundit migrimin shënon rritje të mundshëm, dhe realisht arrin përmasa shqetësuese. Në mënyrë të vazhdueshme.

Numri i të rinjve që lëshojnë vendin, gjimnazistëve dhe studentëve, si dhe personeli me arsim të lartë është në rritje (sidomos nga shkencat teknike dhe natyrore).

Në rrethana të tilla gjatë konceptimit të Politikës së Migracionit për periudhën 2021-2025 vëmendja është përqendruar në tejkalimin e gjendjes ekzistuese të emigrimit të madh dhe të përhershëm i qytetarëve maqedonas jashtë vendit, veçanërisht të rinjve dhe personel me arsim të lartë, si dhe menaxhim efikas të emigracionit, veçanërisht duke u përballur me sfidat e rritjes së emigracionit të paligjshëm.¹⁷

¹⁷ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rezoluta e Politikës së Migracionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2025, Shkup, dhjetor, viti 2021, <https://northmacedonia.iom.int/sites/g/files/tmzbd12301/files/documents/Resolution%20on%20Migration%20Policy%20of%20The%20Republic%20of%20North%20Macedonia.pdf>

TË DHËNAT STATISTIKORE

Të dhënat për studimin aktual u mblodhën gjatë periudhës tre mujore, gjegjësisht shtator-nëntor të vitit 2023 në formën e pyetësorit online të shpërndarë në web faqen e Rrjetit të Grave në Shkencë, faqen e Facebook-ut të RRGSH, CIP dhe nëpër portale të ndryshme në Maqedoninë e Veriut.

Pyetësi, i krijuar për të dhënë njohuri mbi pyetjet e parashtruara në hyrje të këtij punimi, kishte 24 pyetje të organizuara në katër seksione: pyetje biografike (mosha, gjinia, vendi i lindjes, universiteti, viti dhe programi i studimit, arsimimi i prindërve); synimet për të migruar pas përfundimit të studimeve; vendi i synuar i destinacionit dhe stimujt dhe barrierat ndaj tij; dhe ndryshimet e pritura në vend si arsye e qëndrimit në vend. Objektivi themelor i pyetësorit ishte të përputhej qëllimi për të migruar – variabli kryesor i varur – me një gamë të gjerë karakteristikash individuale dhe familjare dhe faktorë të ndryshëm shtytësë dhe tërheqësë.

Tabela dhe figurat në vazhdim paraqesin veçoritë themelore të të anketuarve dhe përgjigjet e tyre ndaj pyetjeve kyçe të përzgjedhura (N=223). Tabela 2 paraqet të dhënat e anketës të cilat pasqyrojnë karakteristikat e 223 të anketuarve, kryesisht të moshës 18-22 vjeç (56.95%). Shpërndarja gjinore nuk është e barabartë, me 27.35% meshkuj dhe 72.65% femra. Shumica e të anketuarve janë banorë urbanë (56.05% kundrejt 43.95% banorë rural). Shqiptarët përbëjnë shumicën e të anketuarve (96.86%), pasuar nga maqedonasit (1.79%) dhe turqit (0.90%). Një pjesë e konsiderueshme kanë arsim të lartë (71.75%) dhe kjo është e evidente edhe tek meshkujt edhe tek femrat. Shumica e prindërve kanë të paktën arsim të mesëm (43.24%). Statusi i punësimit tregon 18.47% të punësuar, 29.28% të papunë dhe 45.05% ende në arsim, me më shumë femra (47.53%) sesa meshkuj (38.33%) në këtë kategori të fundit. Ata që punojnë në biznesin e prindërve të tyre përbëjnë 6.31%, me një përfaqësim më të madh të meshkujve (15%) sesa femrat (3.09%).

Është interesante se nuk ka asnjë të anketuar mashkull që tregon mungesën e nevojës për të punuar, ndërsa 0.9% e të anketuarve femra bëjnë pjesë në këtë kategori. Në përgjithësi, të dhënat ilustrojnë një peizazh të larmishëm të statuseve të punësimit në mesin e popullatës së anketuar, me variacione ndërmjet gjinive dhe një përfaqësim të konsiderueshëm të individëve ende në

fazën arsimore. Të ardhurat familjare kryesisht kalojnë 350 € për anëtar (45.70%). Përafërsisht 9.95% e të anketuarve bien në intervalin 50-100€, me një përfaqësim më të lartë të meshkujve (13.11%) krahasuar me femrat (8.75%). Në intervalin 100-200 €, 18.10% e të anketuarve raportojnë këtë nivel të të ardhurave, me një dallim thelbësor ndërmjet gjinive, 8.20% për meshkujt dhe 21.88% për femrat. Për intervalin 200-350 €, 25.79% e të anketuarve tregojnë këtë nivel të të ardhurave, me një përqindje pak më të lartë të meshkujt (29.51%) krahasuar me femrat (24.38%).

Tabela 2. Karakteristikat e të anketuarve (%)


	Mashkull	Femër	Gjithsej
Mosha			
18 – 22	55.74	57.41	56.95
22 – 26	21.31	18.52	19.28
26 – 30	22.95	24.07	23.77
Gjinia	27.35	72.65	
Vendbanimi			
Fshat	34.43	47.53	43.95
Qytet	65.57	52.47	56.05
Përkatësia etnike			
Shqiptar/e	96.72	96.91	96.86
Maqedonas/e	3.28	1.23	1.79
Turk/e	0.00	1.23	0.90
Boshnjak/e	0.00	0.62	0.45
Niveli i arsimimit			
Arsim fillor	0.00	0.00	0.00
Arsim i mesëm	11.48	11.11	11.21
Arsim i lartë	68.85	72.84	71.75
Studime pasdiplomike	19.67	16.05	17.04
Niveli arsimimit të prindërve			
Arsim fillor	18.03	33.54	29.28

Arsim i mesëm	44.26	42.86	43.24
Arsim i lartë	26.23	16.77	19.37
Studime pasdiplomike	11.48	6.83	8.11
Statusi i punësimit			
I/e punësuar	16.67	19.14	18.47
Punoj në biznesin e prindërve	15.00	3.09	6.31
I/e papunë	30.00	29.01	29.28
Jam ende në studime	38.33	47.53	45.05
Nuk kam nevojë të punoj	0.00	1.23	0.90
Të hyrat familjare			
50-100 € për anëtar familje	13.11	8.75	9.95
100-200 € për anëtar familje	8.20	21.88	18.10
200-350 € për anëtar familje	29.51	24.38	25.79
Mbi 350 € për anëtar familje	49.18	44.38	45.70
Numri i të anketuarve	61	162	223

Në Figurën 1 janë paraqitur rezultatet e të anketuarve mbi nivelin e kënaqësisë ndaj sistemit arsimor, shëndetësor dhe tregut të punës. Të dhënat për kënaqësinë me sistemin arsimor në Maqedoninë e Veriut zbulojnë perceptime të ndryshme në mesin e të anketuarve. Një pjesë e dukshme, 24.66%, shprehën pakënaqësi me sistemin, me një përqindje më të lartë te meshkujt (31.15%) krahasuar me femrat (22.22%). Ndërsa 27.35% tregojnë kënaqësi të moderuar, me një përqindje pak më të lartë tek meshkujt (29.51%). Qëndrimi neutral u zgjodh nga 22.87% e të anketuarve, duke shfaqur një ndryshim domethënës midis gjinive (14.75% meshkuj kundrejt 25.93% femra). Rreth 23.77% raportuan kënaqësi mesatare, me një shpërndarje të balancuar midis meshkujve (22.95%) dhe femrave (24.07%). Kënaqësi shumë të lartë u shpreh vetëm nga 1.35% e të anketuarve, duke treguar variacion minimal gjinor. Si përmbledhje, shumica bie në kategoritë e kënaqësisë së vogël ose mesatare, duke theksuar perceptimet e ndryshme për

sistemin arsimor midis popullatës së anketuar, me dallime të dukshme gjinore në qëndrimin neutral.


Figura 1. Sa i/e kënaqur jeni nga sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë të Veriut? (%)



Sa të kënaqur janë të anketuarit nga shërbimet shëndetësore në institucionet publike apo private në RMV tregon Figura 2.


Të dhënat për kënaqësinë me sistemin shëndetësor në Maqedoninë e Veriut tregojnë rezultate të ndryshme në mesin e të anketuarve. Një pjesë e konsiderueshme, 39.01%, shprehën mungesë kënaqësie ("Aspak"), me një përqindje pak më të lartë te meshkujt (40.98%) sesa te femrat (38.27%). Rreth 29.6% raportuan një nivel të moderuar të kënaqësisë ("Pak"), me femrat (30.86%) që e shprehin këtë ndjenjë pak më shumë se meshkujt (26.23%). Kategoria "Neutrale" u zgjodh nga 18.83% e të anketuarve, duke shfaqur një nivel të qëndrueshëm pasigurie ose indiferencë, me një dallim marginal gjinor. Përafërsisht 12.11% raportuan kënaqësi mesatare ("Mesatarisht i/e kënaqur"), me një përqindje pak më të lartë te meshkujt (14.75%) krahasuar me femrat (11.11%). Një përqindje shumë e vogël (0.45%) ka shprehur kënaqësi shumë të lartë ("Shumë"), me një dallim gjinor marginal 0.62% për femrat dhe asnjë të anketuar mashkull në këtë kategori.

Figura 2. Sa i/e kënaqur jeni nga shërbimet shëndetësore në institucionet publike apo private në RMV? (%)



Të dhënat për kënaqësinë me mundësitë e punësimit në Maqedoninë e Veriut zbulojnë perceptime të dallueshme mes të anketuarve meshkuj dhe femra të paraqitura në figurën 3. Një pjesë e konsiderueshme, 42.15% në përgjithësi, shprehin mungesë të kënaqësisë me mundësitë e punësimit në vend. Kjo ndjenjë është pak më e lartë tek femrat (43.21%) sesa tek meshkujt (39.34%). Rreth 33.63% e të anketuarve treguan një nivel të moderuar të kënaqësisë, me një përqindje pak më të lartë te meshkujt (34.43%) krahasuar me femrat (33.33%). Qëndrimi neutral u zgjodh nga 12.56% e të anketuarve, duke reflektuar një nivel pasigurie ose ambivalence. Femrat (14.2%) kanë më shumë gjasa të zgjedhin këtë opsion në krahasim me meshkujt (8.2%). Përafërsisht 11.21% e të anketuarve raportuan se janë mesatarisht të kënaqur me mundësitë e punësimit. Kjo ndjenjë është dukshëm më e lartë tek meshkujt (18.03%) krahasuar me femrat (8.64%). Një përqindje shumë e vogël e të anketuarve (0.45%) shprehën kënaqësi shumë të lartë, me 0.62% për femrat dhe asnjë të anketuar mashkull në këtë kategori. Pra, shumica e të anketuarve shprehin pakënaqësi ose vetëm një nivel mesatar të kënaqësisë me mundësitë e punësimit në Maqedoninë e Veriut.


Figura 3. Sa i/e kënaqur jeni nga mundësitë që ofron tregu i punës në Republikën e Maqedonisë të Veriut? (%)



Përceptimet mbi mundësitë për të rinjtë janë të paraqitura në tre pyetjet në vazhdim: “Ku planifikoni të jetoni pas përfundimit të shkollimit tuaj?”, “Sipas jush, cilat janë arsytet pse do të vendosnit të qëndroni në Maqedoninë e Veriut?” dhe “Sipas mendimit tuaj, pse largohen të rinjtë nga Maqedonia e Veriut?”.


Të dhënat për planet e ardhshme të jetesës pas përfundimit të arsimit në Maqedoninë e Veriut tregojnë qëllime të ndryshme mes të anketuarve (Figura 4). Një përqindje e konsiderueshme (35.43%) planifikojnë të banojnë në qytetin ku aktualisht studiojnë. Rreth 8.07% kanë aspirata për t’u vendosur në një qytet tjetër brenda Maqedonisë së Veriut, ndërsa një pjesë e konsiderueshme (34.98%) synojnë të jetojnë jashtë vendit. Veçanërisht, 21.52% e të anketuarve shprehin pasiguri, duke deklaruar se nuk kanë ide specifike për rregullimet e tyre të jetesës pas arsimit. Rezultatet sugjerojnë një gamë të larmishme planesh pas arsimit, me një numër të konsiderueshëm duke marrë parasysh opsionet e brendshme dhe ndërkombëtare, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme mbetet e pavendosur për vendbanimin e tyre të ardhshëm.

Figura 4. Ku planifikoni të jetoni pas përfundimit të shkollimit tuaj? (%)




Të anketuarit në Maqedoninë e Veriut identifikojnë arsye të ndryshme për të zgjedhur të qëndrojnë në vend (Figura 5). Arsyeja më e spikatur janë konsideratat e lidhura me familjen, me 42.15% që shprehin angazhimin për të qëndruar për shkak të lidhjeve familjare. Faktorë të tjerë të rëndësishëm përfshijnë zgjidhjen e çështjeve të banimit (9.42%) dhe dëshirën për të kontribuar në vend (24.22%). Një pjesë e konsiderueshme (11.66%) përmendin një preferencë për të mos jetuar në një vend tjetër, ndërsa 3.59% besojnë se do të ishte më e lehtë të gjej punë në Maqedoninë e Veriut. Për më tepër, 8.96% ofruan arsye të tjera për të mos dashur të qëndrojnë në Maqedoninë e Veriut. Rezultatet sugjerojnë se lidhjet familjare, ndjenja e kontributit dhe çështjet e zgjidhura të banimit janë faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimin për të qëndruar në vend, ndërsa një përqindje më e vogël citon konsiderata praktike si mundësitë e punësimit.

Figura 5. Sipas jush, cilat janë arsyet pse do të vendosnit të qëndroni në Maqedoninë e Veriut? (%)



Sipas të dhënave, të anketuarit perceptojnë arsye të ndryshme për emigrimin e të rinjve nga Maqedonia e Veriut (Figura 6). Faktori mbizotërues, siç tregohet nga 53.37%, është mungesa e perceptuar e perspektivës së ardhshme. Një pjesë e konsiderueshme (18.39%) ia atribuon emigrimin e të rinjve politikave të gabuara të qeverisë, ndërsa 21.08% tregojnë nivelin e lartë të papunësisë tek të rinjtë si faktor kyç. Një përqindje më e vogël (3.59%) është e pasigurt ose nuk ka një përgjigje specifike, dhe 3.57% kanë thënë që të gjitha arsyet së bashku janë faktorë që ndikojnë në largimin e të rinjve. Pra, të dhënat sugjerojnë se një ndjenjë mbizotëruese e mundësive të kufizuara për të ardhmen është shtytësi kryesor i emigrimit të individëve të rinj, me shqetësimet për politikën qeveritare dhe papunësinë e lartë të të rinjve që luajnë gjithashtu një rol thelbësor në formësimin e këtij perceptimi.


Figura 6. Sipas mendimit tuaj, pse largohen të rinjtë nga Maqedonia e Veriut? (%)



Të pyetur nëse kanë menduar ndonjëherë të emigrojnë nga vendi për më shumë se një vit, një shumicë e konsiderueshme, 73.54%, janë përgjigjur pozitivisht ("Po"). Përkundrazi, 21.08% janë përgjigjur negativisht ("Jo"), duke treguar se nuk e kanë menduar të emigrojnë për një periudhë të gjatë. Gjithashtu, një pjesë më e vogël (5.38%) janë përgjigjur me pasiguri ose mungesë të një përgjigjeje të qartë ("Nuk e di"). Rezultatet theksojnë se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve e kanë menduar idenë e emigrimit nga Maqedonia e Veriut për një periudhë të gjatë, duke reflektuar një konsideratë të dukshme të largimit nga vendi në mesin e të rinjve të anketuar.

Figura 7 paraqet arsyet kryesore të emigrimit. Arsyeja më e përmendur është pakënaqësia me pagat e ulëta, ku 19.73% shprehin shqetësime për nivelet e pagave. Korrupsioni dhe nepotizmi janë faktorë të rëndësishëm, me 17.49% që theksojnë këto çështje. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, 17.04%, përmendën një standard të ulët jetese, ndërsa 12.56% treguan mungesën e perspektivës për karrierë si një motivues kryesor për të konsideruar emigracionin. Faktorë të tjerë të dukshëm përfshijnë dëshirën për të përmirësuar kushtet ekonomike (9.42%), pamundësinë për të gjetur punë në profesionin e tyre (7.17%) dhe dëshirën për avancim profesional (7.17%). Për më tepër, 7.18% përmendën arsye të tjera. Në përgjithësi, të dhënat nënvizojnë një grup kompleks konsideratash ekonomike dhe profesionale si forcat kryesore shtytëse për të emigruar.

Figura 7. Nëse po, cila është arsyeja kryesore që ju shtyn të mendoni të largoheni nga vendi?



Të pyetur nëse prindërit apo familjarët e tyre e mbështesin vendimin për të emigruar, përgjigjet ndryshojnë. Një pjesë e konsiderueshme, 42.60%, janë përgjigjur pozitivisht ("Po"), duke treguar se prindërit ose familjarët e tyre e mbështesin vendimin. Përkundrazi, 25.11% janë përgjigjur negativisht ("Jo"), duke sugjeruar mungesë mbështetjeje. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (30.49%) kanë përmendur se ende nuk e kanë diskutuar apo zbuluar qëllimin e tyre për të emigruar te prindërit apo familjarët e tyre ("Nuk e kam diskutuar ende").

Një pjesë e dukshme, 37.2%, shpreh synimin për të jetuar përgjithmonë jashtë vendit ("Të jeton jashtë vendit përgjithmonë"), duke treguar një angazhim të fortë për të emigruar. Një numër i

konsiderueshëm, 22.87%, parashikon rikthimin pas një periudhe të caktuar (“Të ktheheni pas një kohe”), duke sugjeruar një emigrim të përkohshëm. Disa të anketuar, 17.04%, deklarojnë se nuk do të mendonin fare të ktheheshin (“Nuk mendoj aspak të kthehem nëse iki”). Gjithashtu, 21.08% shprehin synimin për të vendosur pas vlerësimit të kushteve jashtë vendit. Vetëm një përqindje e vogël tregon pasiguri ose mungesë vendimi për momentin.

Të dhënat tregojnë një sërë prioritetesh dhe konsideratash midis të anketuarve në lidhje me avantazhet e të jetuarit në një vend tjetër. Prioriteti më i përmendur është mundësia për zhvillim personal, e cituar nga 34.53% e të anketuarve. Një pjesë e konsiderueshme, 25.11%, e sheh standardin e lartë të jetesës si një avantazh kyç. Faktorë të tjerë të dukshëm përfshijnë mundësi më të mira pune dhe paga më të larta (17.49%), siguri më të madhe (13.45%) dhe mundësinë për të gjetur një punë më lehtë (5.38%). Disa të anketuar (0.45%) shprehin pasiguri për kushtet në vendet e tjera, ndërsa pak të anketuar (0.45%) përmendin avantazhe të shumta, duke theksuar se të gjitha opsionet e përmendura janë të rëndësishme. Të dhënat nxjerrin në pah perspektivat dhe prioritetet e ndryshme që individët marrin parasysh kur mendojnë të jetojnë në një vend tjetër, ku zhvillimi personal dhe standardi i lartë i jetesës janë faktorë mbizotërues.

Rezultatet nxjerrin në pah nivele të ndryshme të pjesëmarrjes dhe ndërgjegjësimit në lidhje me programet e zhvillimit personal në mesin e popullatës së anketuar në Maqedoninë e Veriut. Një pjesë e konsiderueshme (44.39%) e të anketuarve nuk kanë marrë pjesë kurrë në ndonjë program trajnimi apo iniciativë që synon zhvillimin personal. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm (37.22%) janë angazhuar në mënyrë aktive në disa iniciativa. Një përqindje më e vogël (18.39%) tregon mungesë ndërgjegjësimi për nisma të tilla.

Gjetjet zbulojnë një sërë këndvështrimesh se si anëtarësimi në NATO dhe BE mund të ndikojë në vendimet individuale, duke shfaqur mendime të ndryshme nga ndikimi i rëndësishëm deri tek ndikimi minimal ose aspak. Të dhënat pasqyrojnë nivele të ndryshme optimizmi ose skepticizmi midis të anketuarve në lidhje me efektet e mundshme të anëtarësimit të vendit me NATO-n dhe BE-në në zgjedhjet e tyre personale. Një pjesë e konsiderueshme, 39.46%, beson se anëtarësimi do të ketë ndikim nëse përmirësohet shpejt gjendja ekonomike. Nga ana tjetër, 23.77% besojnë

se anëtarësimi do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë, ndërsa 14.35% mendojnë se do të ketë shumë pak ndikim. Një përqindje e dukshme, 21.08%, beson se anëtarësimi nuk do të ketë fare ndikim.

Faktorë të ndryshëm mund të ndryshojnë potencialisht opinionet e të anketuarve për qëndrimin në Maqedoninë e Veriut. Shumica (59.64%) shprehen se politikat e reja që synojnë përmirësimin e standardit të jetesës mund të ndikojnë në vendimin e tyre. Faktorë të tjerë të përmendur përfshijnë dëshirën për mundësi të përshtatshme pune (20.18%), nevojën për të ardhura për të filluar një biznes (17.94%) dhe minimalizimin e korrupsionit dhe ndryshimit (1.35%). Gjithashtu, një përqindje e vogël e të anketuarve përmendën lodhjen nga vendi (0.90%), pasigurinë (0.45%) dhe dëshirën për ndryshime në profesionin e tyre (0.45%). Rezultatet nxjerrin në pah një përzierje të faktorëve ekonomikë, politikë dhe personalë që mund të ndikojnë në perspektivat e individëve për të mbetur në Maqedoninë e Veriut.

Në pyetjen “Si e shihni rolin e organizatave të sektorit civil në promovimin e të drejtave të të rinjve?” të dhënat tregojnë perceptime të ndryshme. Një pjesë e konsiderueshme (39.91%) beson se këto organizata kanë një kontribut unik dhe të vlefshëm. Megjithatë, shumica (48.43%) nuk sheh ndonjë rol domethënës për këto organizata në promovimin e të drejtave të njeriut. Një pjesë më e vogël (9.87%) kanë qenë personalisht aktiv dhe kanë marrë pjesë në organizata të tilla duke treguar angazhim të drejtpërdrejtë. Një numër i papërfillshëm nuk ka dëgjuar për këto organizata (0.45%), ndërsa të tjerët shprehin pasiguri ose skepticizëm për efektivitetin e tyre.

Gjetjet kryesore përfshijnë një përzierje demografike me një prani të dukshme të të rinjve të moshës 18-22 vjeçe dhe një çekuilibër gjinor që favorizon femrat. Identifikimi etnik është kryesisht shqiptarë, ndërsa nivelet e arsimit variojnë gjerësisht, me një prirje të fortë drejt ndjekjeve të arsimit të lartë. Pakënaqësia me sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit nënvizon fusha kritike për përmirësim. Faktorët ekonomikë ndikojnë shumë në konsideratat e emigrimit, me mbështetje të ndryshme familjare dhe pikëpamje të ndryshme për planet e kthimit. Përparësitë e perceptuara të jetesës jashtë vendit sillen rreth zhvillimit personal dhe standardeve të larta të jetesës. Angazhimi në programet e trajnimit tregon nivele të përzierra pjesëmarrjeje, duke vënë në pikëpyetje efektivitetin e tyre. Anëtarësimi në NATO dhe BE ka ndikime të ndryshme në vendimet individuale. Pritshmëritë për përmirësimin e standardeve të jetesës dhe

mundësive sipërmarrëse janë faktorë kryesorë që ndikojnë në vendimet për të qëndruar. Rolet e organizatave të shoqërisë civile në promovimin e të drejtave të njeriut ngjallin perspektiva të ndryshme. Në përgjithësi, këto gjetje nënvizojnë njohuri thelbësore në dinamikat e ndryshme dhe komplekse brenda Maqedonisë së Veriut.

REKOMANDIMET

Forcimi i mundësive ekonomike:

Zbatimi i politikave për të stimuluar rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës, veçanërisht duke u fokusuar në sektorë që përputhen me aftësitë dhe aspiratat e të rinjve.

Inkurajimi i sipërmarrjes duke ofruar mbështetje financiare, programe mentorimi dhe duke krijuar një mjedis të favorshëm biznesi.

Përmirësimi i programeve të edukimit dhe trajnimit:

Rishikimi i sistemit arsimor për të siguruar përputhjen me kërkesat e tregut dhe për t'i pajisur studentët me aftësi praktike.

Zhvillimi dhe promovimi i programeve të trajnimit profesional që plotësojnë nevojat e industrive të ndryshme, duke nxitur një fuqi punëtore të kualifikuar.

Trajtimi i korrupsionit:

Zbatimi i masave kundër korrupsionit për të rritur besimin e popullatës dhe për të krijuar një strukturë transparente qeverisëse.

Rritja e llogaridhënies dhe reagimit të qeverisë ndaj shqetësimeve të qytetarëve nëpërmjet komunikimit efektiv dhe nismave të pjesëmarrjes.

Investime në sistemin shëndetësor dhe shërbimet sociale:

Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbimet shëndetësore për të adresuar shqetësimet e ngritura në anketë.

Të forcohen sistemet e mbështetjes sociale, duke përfshirë shërbimet e shëndetit mendor, për të ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse të mirëqenies për individët dhe familjet.

Promovimi dhe integrimi i të kthyerve:

Zhvillimi i programeve dhe stimujve për të tërhequr individë të aftë që kanë emigruar, duke krijuar një mjedis që lehtëson riintegrimin e tyre të suksesshëm.

Njohja e ekspertizës dhe përvojave të të kthyerve, duke i përfshirë ata në diskutimet e politikave dhe proceset e zbatimit.

Komunikoni përfitimet e anëtarësimit në NATO dhe BE:

Kryerja e fushatave ndërgjegjësuere për të informuar publikun, veçanërisht të rinjtë, për përfitimet e prekshme të anëtarësimit në NATO dhe BE.

Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile:

Të forcohen partneritetet ndërmjet qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile për të adresuar kolektivisht sfidat shoqërore dhe për të promovuar të drejtat e njeriut.

Angazhimi i organizatave të udhëhequra nga të rinjtë në proceset vendimmarrëse për të siguruar gjithë përfshirje.

Lehtësimi i iniciativave kulturore dhe sociale:

Promovimi i ngjarjeve kulturore, aktivitete sociale dhe nisma për ndërtimin e komunitetit për të krijuar një ndjenjë përkatësie dhe krenarie tek të rinjtë.

Nxjerrja në pah e talenteve vendase, duke nxitur një identitet pozitiv kulturor që kontribuon në mirëqenien e përgjithshme të komunitetit.

LITERATURA

- Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), (2021), Migrimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut: Profili i shtetit 2021, <https://north-macedonia.iom.int>
- Merita Zulfiu Alili, Russell King, Ilir Gëdeshi, Potential Migration of Educated Youth from North Macedonia: Can Brain Drain be Averted?; Migration Letters, (2022), <https://migrationletters.com/index.php/ml/article/view/2093>
- WFD, “Cost of Youth Emigration”, (2018), https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-05/ëfd-web-brochure-nm_final.pdf
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rezoluta e Politikës së Migracionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2025, Shkup, dhjetor 2021, <https://northmacedonia.iom.int/sites/g/files/tmzbd12301/files/documents/Resolution%20on%20Migration%20Policy%20of%20The%20Republic%20of%20North%20Macedonia.pdf>
- Eurostat, General and regional statistics, (2021), <https://ec.europa.eu/eurostat/data/database>
- Enti shtetëror për statistika, Regjistrimi i popullsisë, (2022), <https://popis2021.stat.gov.mk/Активности/Вкупното-резидентно-население-на-Република-Северна-Македонија-изнесува-1-836-713-жители>
- Organisation for Economic Co-operation and Development, Multi-dimensional Review of the Western Balkans (2022), <https://www.oecd.org/countries/republicofnorthmacedonia>
- Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Raporti Vjetor për vitin 2022, (2023), Shkup, <https://av.gov.mk/regjistrimi-ne-evidence.nspx>
- European Commission, North Macedonia 2022 Report, (2022), Brussels, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/North%20Macedonia%20Report%202022.pdf>, fq. 10
- Instituti për të drejtat e njeriut, “Nepotizmi: Autoritetet ndërrohen, "familjarët" mbeten, (2020), Ruzhica Fotinovska, <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/nepotizmi-autoritetet-nderrohenfamiljaret-mbeten.pdf>
- Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit – KSHPK, “Vlerësimi i cenueshmërisë së korrupsionit në politikat dhe procedurat e punësimit, me fokus të veçantë në nepotizmin, miqësinë dhe klientelizmin“ (2020), <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2020>
- EPRS | European Parliamentary Research Service, Legal migration to the EU, (2019), [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635559/EPRS_BRI\(2019\)635559_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/635559/EPRS_BRI(2019)635559_EN.pdf)

SHTOJCA

PYETËSOR MBI EMIGRIMIN POTENCIAL TË TË RINJVE

Rast studimi: Qyteti i Shkupit

I. Të dhënat demografike

Gjinia

1. Mashkull
2. Femër

Mosha

- a. 18 – 22
- b. 22 – 26
- c. 26 – 30

Venbanimi: _____

Përkatësia etnike: _____

II. Statusi socio-ekonomik i të anketuarit

2.1 Niveli edukimit:

- a. Arsim fillor
- b. Arsim të mesëm
- c. Arsim të lartë
- d. Arsim pasuniversitar

2.2 Niveli i arsimimit të prindërve:

- e. Arsimim fillor
- f. Arsimim të mesëm
- g. Arsim të lartë
- h. Studime pasdiplomike (master ose doktoraturë)

2.3 Statusi i punësimit

- a. Jam i/e papunë
- b. Punoj në biznesin e prindërve
- c. Jam ende në studime
- d. Nuk kam nevojë të punoj

2.4 Të hyrat familjare:

- a. 50-100 € për anëtar familje
- b. 100-200 € për anëtar familje
- c. 200-350 € për anëtar familje
- d. Mbi 350 € për anëtar familje

Nr.	<i>PYETJE MBI NIVELIN E KËNAQËSISË NDAJ SISTEMIT ARSIMOR, SHËNDETËSOR, TREGUT TË PUNËS, ETJ</i>	
1.	Sa i/e kënaqur jeni nga sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë të Veriut	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aspak 2. Pak 3. Neutral/e 4. Mesatarisht i/e kënaqur 5. Shumë
2.	Sa i/e kënaqur jeni nga shërbimet shëndetësore në institucionet publike apo private në RMV?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aspak 2. Pak 3. Neutral/e 4. Mesatarisht i/e kënaqur 5. Shumë
3.	Sa i/e kënaqur jeni nga mundësitë që ofron tregu i punës në Republikën e Maqedonisë të Veriut	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aspak 2. Pak 3. Neutral/e 4. Mesatarisht i/e kënaqur 5. Shumë
<i>PERCEPTIME MBI MUNDËSITË PËR TË RINJTË</i>		
1.	Ku planifikoni të jetoni pas përfundimit të shkollimit tuaj?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në qytetin ku studioj 2. Në një qytet tjetër në Maqedoninë e Veriut 3. Jashtë shtetit 4. Nuk e kam aspak idenë
2.	Sipas jush, cilat janë arsytet pse do të vendosnit të qëndroni në Maqedoninë e Veriut?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Më lehtë do të gjej punë 2. Për arsye familjare 3. E kam të zgjidhur çështjen e banimit 4. Nuk dua të jetoj në vend tjetër 5. Dua të jap kontribut në vendin tim 6. Tjetër _____
3.	Sipas mendimit tuaj, pse largohen të rinjtë nga RMV?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk shohin perspektivë për të ardhmen e tyre 2. Për shkak të politikave të gabuara të

		qeverisë 3. Për shkak të nivelit të lartë të papunësisë tek të rinjtë 4. Nuk e di/nuk kam përgjigje 5. Arsye tjetër _____
PYETJE MBI EMIGRIMIN POTENCIAL		
1.	A keni menduar ndonjëherë të largoheni nga vendi më tepër se një vit (emigroni)?	1. Po 2. Jo 3. Nuk e di
2.	Nëse po, cila është arsyeja kryesore që ju shtyn të mendoni të largoheni nga vendi?	1. Mungesa e perspektivës për të bërë karrierë 2. Korrupsioni, nepotizmi i elitave politike 3. Dua të përmirësoj gjendjen ekonomike 4. Pamundësia për të gjetur punë në profesion 5. Pamundësia për të gjetur çfarëdo lloj pune 6. Pagat e ulëta 7. Pamundësia për të përparuar profesionalisht 8. Standardi i ulët jetësor 9. Tjetër _____
3.	A e mbështesin prindërit ose familjarët tuaj zgjedhjen për të emigruar jashtë vendit?	1. Po 2. Jo 3. Nuk e kam diskutuar ende 4. Tjetër _____
4.	Nëse do të kishit vendosur të emigroni, a mendoni:	1. Të jetoni jashtë vendit përgjithmonë 2. Të ktheheni pas një kohë të caktuar 3. Të vendosni pasi ti keni parë kushtet e jetesës atje 4. Nuk mendoj aspak të kthehem nëse iki
5.	Sipas jush cilat janë përparësitë e të jetuarit në ndonjë vend tjetër jashtë RMV-së?	1. Lehtë gjendet vend pune 2. Puna paguhet shumë më mirë 3. Mundësi më të mira për zhvillim personal dhe profesional 4. Standard i lartë jetësor

		5. Siguri më e madhe 6. Tjetër _____
6.	A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim/program/iniciativë që synonte formimin profesional të të rinjve?	1. Jo, asnjëherë 2. Nuk kam dëgjuar ndonjëherë për iniciativa të tilla 3. Po, kam marrë pjesë në disa 4. Tjetër _____
PERCEPTIMET MBI PERSPEKTIVËN E VENDIT		
1.	Si mendoni se do të ndikojë largimi i të rinjve nga vendi në ardhmërinë e kombit?	1. Shqiptarët do të getoizohen 2. Shqiptarët do të asimilohen 3. Shqiptarët do të evropianizohen 4. Nuk më intereson
2.	A mendoni se anëtarësimi i vendit në NATO dhe BE, do të ndikojë në vendimin tuaj për mos tu larguar nga vendi?	1. Do të ketë ndikim 2. Do të ketë shumë pak ndikim 3. Do të ketë ndikim nëse përmirësohet shpejt gjendja ekonomike 4. Nuk do të ketë fare ndikim
ALTERNATIVA TË REJA		
1.	Çfarë mund t'ju bëjë të ndryshoni mendimin për të qëndruar në Maqedoninë e Veriut?	1. Të siguroj punë të përshtatshme sa më shpejt. 2. Të kem të ardhura për të nisur biznes personal 3. Politika të reja për rritjen e standardit të jetesës 4. Tjetër _____
2.	A do të merrnit pjesë në ndonjë program të formimit profesional dhe punësimit të të rinjve?	1. Nuk e di për çfarë bëhet fjalë 2. Nuk kam dëgjuar për të tilla iniciativa 3. Patjetër që do të merrja pjesë 4. Nuk mendoj se do ndikonte në përmirësimin e jetës sime 5. Mendoj se programe të tilla nuk janë efektive 6. Tjetër _____
3.	Si e shihni rolin e organizatave të sektorit civil në promovimin e të drejtave të të	1. Mendoj se kanë kontribut të veçantë 2. Nuk mendoj se kanë ndonjë rol

	rinjve?	domethënës 3. Personalisht kam qenë aktiv/e dhe kam përfituar shumë prej tyre 4. Tjetër _____
--	---------	---